

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

Prodhimi I ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to

ID 7.7/i “Prodhimi I birrës”

(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)



Subjekti: “KOSTANA” Sh.p.k.

NIPT L04105003C

Vendndodhja: Korçë, Rr. “Tefta Tashko Koço”, Ish fabrika e Qelqit.

1. PROFILI I KOMPANISE

Subjekti “KOSTANA” Sh.p.k. është regjistruar ne QKB me numër NIPT L04105003C dhe administrator Z. Elvis Saraçi.

Profili I kompanise konsiston ne prodhimin, tregetin e pijeve alkoolike, respektivisht birres. Operatori ne qender te vemendjes ka cilesine konform standarteve dhe permbushjen e kerkesave te cdo klienti.

Aktiviteti i prodhimit të planifikuar i përket të gjithë ciklit të prodhimit të birrës me përjashtim të kultivimit dhe maltimit të elbit. Prandaj, procesi i prodhimit është i përcaktuar me blerjen e malteve (duke përdorur përzierjet e malteve me karakteristika dhe trajtime të ndryshme) dhe materiale të tjera të papërpunuara (maja, sheqer, fruktoza, mjaltë,).

Subjekti “KOSTANA” Shpk do te aplikojë për t’u pajisur me leje tip B.

Klasifikimi bazuar ne ligjin 10448 datë 14.07.2011, të ndryshuar:

**Prodhimi I ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to;
ID 7.12/i “Prodhimi I birrës”**

Referuar shtojces 1 te ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR.

2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

- ❖ Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:
 - Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
 - Ndikimi ne flore/faune;
 - Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
 - Ndikime social-ekonomike;
 - Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
 - Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
 - Ndikim ne peizazhin e zones;

- ❖ Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

3. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Vendndodhja e aktivitetit është: **Korçë, Rr. “Tefta Tashko Koço”, Ish fabrika e Qelqit.**

Infrastruktura është ekzistuese dhe për zhvillimin e aktivitetit ne fjale nuk është e nevojshme hapja e rrugëve të reja. Në funksion të aktivitetit te mesiperm do të përdoren rrugët ekzistuese të aksesit.

Nepermjet ortofotos se meposhteme jepet vendndodhja e subjektit “Kostana” Shpk.



Koordinatat sipas Gauss Kruger

Nr.	X	Y
1.	4482864.94	4497590.69

4. PERSHKRIMI AKTIVITETIT

ID 7.12/i “Prodhimi I birrës”

Aktiviteti i prodhimit të planifikuar i përket të gjithë ciklit të prodhimit të birrës me përjashtim të kultivimit dhe maltimit të elbit. Prandaj, procesi i prodhimit është i përcaktuar me blerjen e malteve (duke përdorur përzierjet e malteve me karakteristika dhe trajtime të ndryshme) dhe materiale të tjera të papërpunuara (maja, sheqer, fruktoza, mjaltë,).

a) Qëllimi i projektit

Qëllimi i këtij projekti është prodhimi i pijeve alkoolike, konkretisht prodhimi i birrës.

Proçesi i prodhimit të birrës.

▪ *Grirja e maltit*

Birra prodhohet nga lloje të ndryshme malti ,të cilat pasi peshohen bluhën në mulli i cili programohet manualisht në atë mënyrë në bazë të stilit të birrës që do të prodhosh.

▪ *Zierja e maltit*

Mbushim kazanin e zjerjes me ujë dhe në një temperaturë nga 60°C – 66°C bëjmë zjerren e maltit për një kohë rreth një orë.

▪ *Standartizimi i amilazit*

Kur ky transformim është përfunduar bëjmë standartizimin e këtij proçesi me një ritje temperaturë të caktuar.

▪ *Aromatizim*

Proçesi tjetër i radhes është filtrimi i lëngut nga malti në një kazan tjetër nga ai i zjerjes,ku bëhet edhe aromatizimi i birres me humulus në një temperaturë 1000 C për afërsisht për 60min kohë.

▪ *Fermentimi*

Mushti i prodhuar nga zjerrja që të transformohet në birrë dhe të prodhohë gradën alkoolike të duhur, futet në fermentator me majanë e duhur,për stilin e përcaktuar të birrës. Në bazë të stilit që do të prodhohet dhe lëndës të parë të përdorur,koha e fermentimit mund të variojë nga 20 – 60 ditë

▪ *Ambalazhimi*

Pas proceseve të mësipërme, birra e prodhuar ambalazhohet dhe lihet nga 10 - 30 ditë për maturim në shishe.

Pas këtij procesi, produkti përfundimtar birrë është gati për konsum njerëzor.

Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre

Lëndët e para te nevojshme për prodhimin e birres janë malto, maja birre, karton filtra steril etj.

Për larjen e tankeve dhe fucive përdoret sode kaustike.

Për prodhim të birres si **lende e pare** përdoret: Malto, produkt cili merret i gatshëm.

Si lende ndihmese: Maja birre, Lupolo (për shijen e birres)

Produkte: birre, 100% birre malti

Produkte te ndermjetme: nuk ka

Lende te tjera ndihmese: Uji dhe energjia elektrike

Infrastruktura e nevojshme

Furnizimi me energji

Energjia elektrike sigurohet nga rrjeti ekzistues i zones, janë bërë të gjitha instalimet e nevojshme elektrike. Furnizimi ekzistues me energji elektrike i këtij territori është ai i Bashkisë.

Furnizimi me uje

Uji teknologjik i nevojshëm për zhvillimin e aktivitetit do të sigurohet nga rrjeti i godines, objekti e ka të gjithë infrastrukturen e ngritur, komform të gjitha kushteve e rregullave në fuqi duke lidhur një kontratë të rregullt të furnizimit me uje me ujesjellsin e zones.

Rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja

Infrastruktura është ekzistuese dhe për zhvillimin e aktivitetit në fjalë nuk është e nevojshme hapja e rrugëve të reja. Në funksion të aktivitetit të mesipër do të përdoren rrugët ekzistuese të aksesit.

Prona ku është propozuar zhvillimi i aktivitetit “Prodhimi i birres” ndodhet në një zonë ku ka mundësi aksesuese të rrugëve ekzistuese.

5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMIT I SHKARKIMEVE NE MJEDIS

SHKARKIME NE AJER

Ushtrimi I ketij aktiviteti nuk do te ndikoje ne cilesine e ajrit te zones, pasi nuk do te kete shkarkime ne ajer te gazeve, pluhurave apo tymrave. Te vetmet shkarkime ne ajer do te jene ato te cilat vijne si pasoje e mjeteve transportuese te lendes se pare dhe te produktit perfundimtar si dhe do te gjenerohen aroma nga perdorimi I majase. Per kete te fundit punonjesit te cilet kane kontakt te vazhdueshem me sektorin ku perdoret majaja, do te pajisen me mjete mbrojtese si maska per te ruajtur shendetin e tyre.

SHKARKIME NE UJERA

Ushtrimi I ketij aktiviteti nuk do te ndikoje ne ndryshimin e nivelit te ujerave tokesore, ne rruget ujore dhe ne nivelin hidrostatik te ujerave nentokesore, pasi ne kete zone ku ndodhet objekti dhe perreth tij nuk ka burime ujore nentokesore dhe shpime te ndryshme hidrogjeologjike qe mund te demtoheshin nga ushtrimi I ketij aktiviteti. Aktiviteti do te shoqerohet me shkarkime ne kanalizime te ujerave teknologjike. Shkarkimet e ujerave te ndotura do te behen ne rrjetin e Ujesjelles Kanalizime te zones. Godina e ka te instaluar te gjitha rrjetin e nevojshem per shkarkimet e ujerave te ndotura (ujerave te zeza).

SHKARKIME NE TOKE

Ushtrimi I aktivitetit te prodhimit te birres nuk shoqerohet me shkarkime ne toke, rrjedhimisht nuk kemi ndryshim te cilesive te saj.

ZHURMA

Do te kemi gjenerim te zhurmave nga pajisjet qe perdoren ne proceset e prodhimit te birres. Per minimizimin e ketyre zhurmave, cdo pajisje apo mjet qe perdoret nga kompania do t'i nenshtrohet kontrollit periodik sipas legjislacionit rrugor.

MBETJE TE NGURTA

Do te kemi gjenerim te mbetjeve urbane qe kryesisht do te vijne nga aktiviteti I punonjesve. Gjenerimi i mbetjeve urbane do te jete ne sasi minimale. Largimi i tyre do te behet ne menyre periodike ne vendet e percaktuara nga Njesia e Pushtetit Vendor.

NDIKIME NE FLORE DHE FAUNE

Zona ne te cilen ushtrohet aktiviteti eshte nje zone ne te cilen nuk takohen elemente te spikatur te flores dhe faunes per vete faktin se aktiviteti zhvillohet ne nje zone urbane. Perreth kesaj zone mund te hasim bimesi te ulet kryesisht dekorative dhe barishte. Aspekti faunistik paraqet nje larmi biologjike te varfer. Zhvillimi I ketij aktiviteti nuk paraqet asnje ndikim negativ ne flore apo faune.

Rrezatimi Jonizues

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi rrezatime jonizuese.

Ndikimet ne popullsi

Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit ku do zbatohet projekti. Gjate funksionimit te aktivitetit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje, te cilat ndotin ambjentin dhe te rrezikojne shendetin e popullsisë se rajonit.

NDIKIM SOCIAL-EKONOMIK

Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e vendit. Operatori do te punesoje personel te zones, duke bere te mundur rritjen e nivelit ekonomik dhe te punesimit.

SUBJEKTI

“KOSTANA” Sh.p.k.

Administrator

Elvis Saraçi